



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 725 , Datë 19.11.2020

**“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2020  
“Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e  
importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe  
tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe  
tregtimit me shumicë të termometrave””**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.11.2020, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 716, datë 15.10.2019 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave””.

**Baza Ligjore:** Neni 4, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 43, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

**VËREN SE :**

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 716, datë 15.10.2020, vendosi:

- I. Hapjen e Procedurës së Hetimit të Thelluar ndaj ndërmarrjeve “CFO Pharma” SHPK, “Rejsi Farma” SHPK, “Delta Pharma – AL” SHPK, “Pharma One” SHPK, “Intermed” SHPK, “Alfarmakos” SHPK, “Trimed” SHPK, “Megapharma” SHPK, “Evita” SHPK, “Aldosch – Farma” SHPK, “IMI – Farma” SHPK, “Fufarma” SHA, “Medicamenta” SHPK, “Mini Invest Albania” SHPK, “Delta Med” SHPK, “R&S Farma” SHPK, “O.E.S Distrimed” SHPK, “Montal” SHPK, “MSE” SHPK, “Farma Net Albania” SHPK, “Tresi – Farm” SHPK, “Incomed” SHPK, “Florifarma” SHPK, “Lekli” SHPK, “Dial – ALB” SHPK, “Sirol 2008” SHPK, “Aquila Group” SHPK:
  - i. në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave;
  - ii. në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-

- dezinfektues;
- iii. në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave.
- II. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.09.2020.
- III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 muaj nga hapja e hetimit të thelluar.
2. Komisioni i Konkurrencës, vlerëson se me qëllim realizimin e një analize të plotë të sjelljes së ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave si dhe për shkak të kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, është e nevojshme shtyrja e periudhës kohore të hetimit të thelluar deri në datën 31.12.2020.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

#### **VENDOSI:**

- I. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 717 datë 15.10.2020 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj disa ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe gel-dezinfektues, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave”, pika “2”, të ndryshohet si vijon:
2. *“Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.11.2019 deri në 31.12.2020”.*
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**